



Përktheu dhe përgatiti:
Ymer MUSA

Lutjet e jetës



Nga Kur'ani dhe hadithi
(botimi i dytë i përmirësuar)

Përmbajtja

Transkriptimi arabisht – shqip	6
Hyrje	10
Kur zgjohesh nga gjumi	12
Kur t'i veshësh rrobat	13
Kur t'i veshësh rrobat e reja	13
Kur t'ia shohësh vëllait tënd një teshë të re	14
Kur të dalësh nga shtëpia yte	15
Kur të hyshë në shtëpinë tënde	16
Kur të hipësh në mjetin bartës	16
Kur të hyshë në nevojtoare (banjo)	18
Abdesti	19
Kur të nisësh për në xhami	20
Vlera e shkuarjes në xhami	21
Kur të hyshë apo të dalësh nga xhamia	21
Shtesë e vlefshme	22
Kur ta dëgjosh ezanin	23
Kur ta marrësh tekbinin fillestar për namaz	25
Kur shkon në ruku	26
Në ruku dhe në sexhde	27
Gjatë sexhdes	27
Kur të ngrihesh nga rukuja	28
Mes dy sexhdeve	30
Pasi ta përfundosh teshehudin	30

Lutjet e mëngjesit dhe të mbrëmjes.....	35
Lutjet të cilat nuk përcaktohen me kohën.....	45
Ruajtja nga shejtani.....	46
Konstatim.....	47
Sunnetet e rregullta.....	48
Falja e namazit të natës dhe vitri	48
Pas faljes së vitrit	48
Lutja dhe kërkimi i faljes në fund të natës.....	50
Namazi i paraditës (Duha)	50
Namazi i istihares.....	50
Namazi i pendimit.....	52
Zemra e istigfarit	53
Namazi për ndonjë nevojë.....	54
Salavati mbi Pejgamberin ﷺ	54
Selami - përshëndetja	55
Ushqimi.....	57
Kur na ofrohet ushqimi.....	57
Pas ushqimit.....	58
Kur të shkosh në gosti	59
Urata për martesë	59
Me çka kërkohet mbrojtja për fëmijët dhe për të tjerët (me cilat fjalë duhet t'u fryjmë)	61
Udhëtimi	62
Kur të arrish në vendin e synuar.....	64
Duatë e gjumit	65
Ëndrra	68
Kur trembesh në gjumë	69

Kur ke frikë nga dikush	72
Kur të ngarkon ndonjë çështje	72
Kur të të vështirësohet ndonjë çështje	73
Kur të hidhërohesh	73
Kur të ndodhë ajo që nuk e zgjedh	73
Kur të ndodhë ajo që nuk e zgjedh	73
Kur të sprovohesh me borxh.....	74
Kur të ndodhë ndonjë fatkeqësi e madhe apo e vogël	74
Kur ankohesh për ndonjë sëmundje në trup	75
Me çka duhet fryer të sëmurin	75
Kur ta vizitosh të sëmurin	76
Në rast vdekjeje	76
Kur t'i shprehësh ngushëllime një muslimani	77
Kur t'i vizitosh varrezat.....	78
Kur të fryejë era.....	79
Kur të bubullojë	79
Kur e sheh hënën e re në fillim të muajit.....	80
Kur ta shohësh hënën	81
Kur të errësohen dielli apo hëna.....	81
Teshtitja dhe hapja e gojës	81
Kur sheh diçka që të pëlqen.....	82
Kur sheh diçka që e urren.....	83
Kur rri në ndonjë ndejë e pastaj ngrihesh	83
Kur e sheh vëllain tënd duke qeshur	84

Kur ta dëgjosh zërin e gjelit apo të gomarit	85
Kur të hysh në treg	85
Kur të bëhet ndonjë e mirë	86
Vlera e duasë	86
Nga duatë e Kur'anit	87
Nga duatë e përgjithshme të Pejgamberit ﷺ	94
Leximi i Kur'anit	97
Ruajtja e gjuhës	99
Ndalimi i përgojimit	100
Ndalimi i bartjes së fjalëve (nemimeti)	103
Llogaria ditore	105
Istigfari	108
Literatura e shfrytëzuar	109
Referencat e haditheve	111

Transkriptimi arabisht – shqip

Gjuha arabe i ka 28 shkronja të cilat njëkohësisht janë edhe bashkëtingëlloret e saj. Zano-ret e gjuhës arabe nuk janë shkronja por shënohen si shenja. Çdo gjuhë i ka shkronjat e veta dhe mënyrën e artikulimit të tyre. Shkronjat të cilat i hasim në arabisht e jo edhe në shqip ose të cilat dallojnë nga ato të shqipes në vendartikulim e të cilave në transkriptim u kemi dhënë formë të veçantë, janë këto:

Ĥ, ĥ - Vendartikulimi i kësaj shkronje është mesi i fytit. Nga **h**-ja e shqipes dallon ngase në shqiptim: duhet ta shtrëngojmë mesin e fytit dhe duhet ta shqiptojmë rrjedhshëm.

Ħ, ħ - Vendartikulimi i kësaj shkronje është pjesa më e afërme e fytit. Nga **h**-ja e shqipes dallon ngase në shqiptim duhet ta shtrëngojmë pjesën e afërme të fytit dhe duhet ta shqiptojmë duke e grithur fytin.

Š, š - Vendartikulimi i kësaj shkronje është maja e gjuhës dhe mesi i dhëmbëve të përparmë. Dallon nga **s**-ja e shqipes, ngase në shqiptim shkronjën duhet ta shqiptojmë trashë.

anësorja e gjuhës. Dallon nga **d**-ja e shqipes, ngase në shqiptim duhet bashkuar njëjërën prej anësoreve të gjuhës me dhëmballët dhe duhet ta shqiptojmë më trashë.

Ṭ, ṭ - Vendartikulimi i kësaj shkronje është maja e gjuhës e përputhur me pjesën e epërme të qiellzës e të dhëmballëve të përparmë. Dallon nga **t**-ja e shqipes ngase duhet ta shqiptojmë më trashë.

ḌH, ḍh - Vendartikulimi i kësaj shkronje është mesi i majës së gjuhës dhe i majës së dhëmbëve të përparmë. Dallon nga **dh**-ja e shqipes ngase duhet ta shqiptojmë më trashë.

Ā, ā - Vendartikulimi i kësaj shkronje është mesi i fytit. Dallon nga **a**-ja e shqipes ngase në shqiptim duhet ta shtrëngojmë fytin fortë e pastaj ta shqiptojmë shkronjën. Kur pas kësaj shkronje vjen ndonjë zanore, në atë rast ajo shqiptohet në bazë të zanores, andaj edhe e kemi vënë shenjën mbi zanoren përkatëse si **Ū, ū** dhe **Ī, ī**

Ķ, ķ - Vendartikulimi i kësaj shkronje është në mes të grykës së fytit dhe gurrmazit. Dallon

të shprehet më e fortë dhe më pëlçitëse.

G, g - Dallon nga **g**-ja e shqipes, ngase gjatë shqiptimit duhet ta shqiptojmë si të shkrirë, sidomos kur vjen para bashkëtingëllores ku nuk duhet të hetohet **ë**-ja mes tyre.

K, k - Dallon nga **k**-ja e shqipes, ngase gjatë shqiptimit duhet të shqiptohet shumë më e butë dhe më pak e theksuar.

V, v - Dallon nga **v**-ja e shqipes, ngase gjatë shqiptimit duhet të shqiptohet si **w**-ja e anglishtes, gjegjësisht mes **u**-së dhe **v**-së në shqip.

Tri shkronjat e fundit edhe pse dallojnë në shqiptim nga ato të shqipes, nuk do të dallojnë edhe në transkriptim.

Zanoret e gjata:

Ā,ā; Ū,ū; Ī,ī; Këto shkronja janë të njëjta me **a**-në, **u**-në dhe **i**-në e shqipes, përpos se shenja e cila është vënduar mbi to e cila i ngjanë shenjës së medit të arabishtes, tregon se zanorja duhet të zgjatet.

Vërejtje: Për t'u shprehur rrokja në gjuhën arabe, vihet një shenjë mbi shkronjën e cila quhet **sukūn**. Në disa raste për shkak të drejtë-

shkronjës ku formohet rrokja si p.sh. **vedâ'tu**, **mu'minîne**. Kurse vizën (-) e kemi përdorur në rast të **II**-së së dyfishuar ose kur dy fjalë në shqiptim lexohen bashkë, meqë fundi i të parës dhe fillimi i të dytës kanë të njëjtën shkronjë në transkriptim.

I falënderohem përzemërsisht vëllait tim, Gazmend Hoxhës, i cili përkundër angazhimeve të shumta që i kishte, më nderoi për përgatitjen e shkronjave të transkriptimit, të cilat i vendosi në një font të veçantë.

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اذْكُرُوا اللّٰهَ
ذِكْرًا كَثِيرًا وَسَبِّحُوهُ بُكْرَةً وَأَصِيلًا ﴾

*“O ju që besuat, përkujtuni All-llahun sa më shpesh,
dhe madhërojeni Atë mëngjes e mbrëmje”.*

(Ahzabë, 42)

Hyrje

Gjendja më e mirë e besimtarit është kur ai e bën dhikër Zotin e botëve dhe kur merret me dua të cekura nga i Dërguari ﷺ, zotëriu i të gjithë të dërguarve.

I Dërguari ﷺ ka thënë: “Vërtet, veprat vlerësohen sipas qëllimit dhe çdo person shpërblehet ashtu si e ka pasur qëllimin: Kush bëri hixhret për All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, hixhreti i tij vlerësohet për All-llahun dhe Pejgamberin e Tij. Kush bëri hixhret për dunja që të përfitojë

* ﷺ - Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem (Bekimi dhe paqja e All-llahut qofshin mbi të)

hixhreti i tij vlerësohet për atë që e bëri hixhretin”.¹ I Dërguari i All-llahut thoshte: “Shembulli i atij që përmend Zotin e tij dhe atij që nuk e përmend, është si shembulli i të gjallit me të vdekurin”.² Një njeri i tha Pejgamberit ﷺ: “O i Dërguari i All-llahut, detyrimet e Islamit më janë shtuar, andaj më trego diçka (të lehtë) që t’i përmbahem asaj”. Ai i tha: “Le të jetë gjithmonë gjuha jote e freskët nga të përmendurit e All-llahut”.³ I Dërguari ﷺ ka thënë: “All-llahu i lartësuar thotë: Unë jam me kujtesën e robit Tim kur më kujton dhe unë jam me të kur Më përmend. Nëse Më përmend në vete, e përmendi në Vete, e nëse më përmend në një shoqëri njerëzish, e përmendi në një shoqëri edhe më të mirë se ata (synon melekët)”.⁴

Këto dhikre robi nuk bën t’i braktisë sepse ai ka nevojë të madhe për to dhe me to përfiton shpërblime në atë dhe këtë botë.

Thuaj:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَحْيَانَا بَعْدَ مَا أَمَاتَنَا وَإِلَيْهِ النُّشُورُ

Elhāmdulil-lāhil-ledhī aḥjānā bādemā emātenā
ve ilejhin-nushūr

“Falënderim All-llahut i cili na ngjalli pasi na bëri të vdekur dhe te Ai është rikthimi”.⁵ Po ashtu mund të thuash:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي رَدَّ عَلَيَّ رُوحِي ، وَعَافَانِي فِي جَسَدِي
وَأَذِنَ لِي بِذِكْرِهِ

Elhāmdulil-lāhil-ledhī redde ālejje rūhī ve
āāfānī fī xhesedī ve edhine lī bi dhikrih

“Falënderim All-llahut i cili ma ktheu shpirtin, ma ruajti me shëndet trupin dhe ma bëri të mundshme ta përkujtoj Atë”.⁶

I Dërguari ﷺ ka thënë: Ai që e veshë një teshë dhe thotë:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي كَسَانِي هَذَا الثَّوْبَ وَرَزَقَنِيهِ مِنْ غَيْرِ حَوْلٍ مِنِّي
وَلَا قُوَّةَ

Elhāmdulil-lāhil-ledhī kesānī hādheth-thevbe
ve rezeķanīhi min ġajri hāvlin minnī ve lā
kuvveh

“Falënderim All-llahut i cili ma mundësoi ta vesh këtë teshë dhe më furnizoi me të pa ndonjë mundim e fuqi nga ana ime”, atij i falen gjynahet e kaluara”.⁷

Kur t'i veshësh rrobat e reja

Përmende teshën me emër (këmishë, xhaketë etj.) dhe thuaj:

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ كَسَوْتَنِيهِ ، أَسْأَلُكَ خَيْرَهُ وَخَيْرَ مَا صُنِعَ
لَهُ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهِ وَشَرِّ مَا صُنِعَ لَهُ

All-llāhumme lekel hāmdu ente kesevtenih.
Es'eluke hājrehū ve hājre mā šuniā lehū ve
eūūdhu bike min sher-rihī ve sher-ri mā šuniā
leh

ngase Ti ma bëre të mundshme ta veshë. Të lus për të mirën e saj dhe për të mirën që është prodhuar. Kërkoj të më ruash nga e keqja e saj dhe nga e keqja për të cilën është prodhuar”.⁸

Kur t’ia shohësh vëllait tënd një teshë të re

Thuaji atij:

الْبَسْ جَدِيداً، وَعِشْ حَمِيداً، وَمُتْ شَهِيداً

Ilbes xhediden ve ish hamiden ve mut
shehiden

“Mbajtsh përherë tesha të reja, jetofsh i falënderuar dhe vdeksh dëshmor”.⁹

Nëse e vesh teshën ose i mbathë këpucët, mbathi me të djathtën dhe zbathi me të majtën sepse i Dërguari ﷺ ka thënë: “Kur të visheni ose të merrni abdest, filloni me të djathtën”.¹⁰

I Dërguari ﷺ ka thënë: Kush thotë (kur del nga shtëpia e tij):

بِسْمِ اللَّهِ، تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

Bismil-lāhi, tevekkeltu âlall-llāhi velā hāvle velā kuvvete il-lā bil-lāh

“Me emër të All-llahut, i jam mbështetur All-llahut dhe nuk ka ndryshim e as fuqi pos me All-llahun”, në atë rast atij i thuhet: “Mjafton, u mbrojte dhe u udhëzove, dhe shejtani largohet nga ai”.¹¹

Nga Ummi Seleme radijall-llahu anha përcillet se ajo ka thënë: I Dërguari ﷺ asnjëherë nuk ka dalur nga shtëpia ime pa mos e drejtuar shikimin kah qielli dhe të thotë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَضِلَّ أَوْ أُضَلَّ، أَوْ أَزِلَّ، أَوْ أُزَلَ، أَوْ أَظْلِمَ أَوْ أُظْلِمَ، أَوْ أَجْهَلَ أَوْ يُجْهَلَ عَلَيَّ

All-llāhumme innī eūūdhu bike en eḍil-le ev uḍal-le ev ezil-le ev uzal-le ev aḍhlime ev uḍhleme ev exhhele ev juxhhele ālej

“O All-llahu im, kërkoj mbrojtje te Ti që të mos devijoj ose të mos më devijojnë të tjerët, të zhytem ose t’më zhysin të tjerët, të futem në zullum ose t’më fusin në zullum të

Thuaj:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَ الْمَوْلِجِ وَخَيْرَ الْمَخْرَجِ،

بِسْمِ اللَّهِ وَجِنَا وَبِسْمِ اللَّهِ خَرَجْنَا، وَعَلَى اللَّهِ رَبِّنَا تَوَكَّلْنَا

All-llāhumme innī es'eluke ħajrel mevlexhi ve ħajrel maħrexhi. Bismil-lāhi velexhnā ve bismil-lāhi ħarexhnā ve ālall-llāhi rabbinā tevekkelnā

“O All-llahu im, kërkoj të ma mundësosh hyrjen dhe daljen e hajrit. Në emër të All-llahut hymë dhe në emër të All-llahut dalim dhe në All-llahun, Zotin tonë, jemi mbështetur”. Pastaj le ta përrshëndesë me selam familjen e tij.¹²

Kur të hipësh në mjetin bartës

Kur e vë këmbën tënde në të, thuaj:

بِسْمِ اللَّهِ

Bismil-lāh (Me emër të All-llahut), e kur të vendosesh në të thuaj:

الْحَمْدُ لِلَّهِ

El-ĥamdulil-lāh (Falënderim All-llahut).

سُبْحَانَ الَّذِي سَمِعْنَا نَدَاءَ رَبِّنَا وَقَامَنَا
مُقْرِنِينَ وَإِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ

Subhānel-ledhī seḥhare lenā hādhā ve mā
kunnā lehū muḥrinīn. Ve innā ilā rabbinā le
munkalibūn

“I dëlirë është Ai që i nënshtroi këto për ne,
sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim
këtë. Dhe ne me siguri do të kthehemi te Zoti
ynë”. (*Zubruf, 13-14*)

الْحَمْدُ لِلَّهِ

El-ḥamdulil-lāh - thuaj tre herë,

اللَّهُ أَكْبَرُ

All-llāhu ekber (All-llahu është më i madhi),
po ashtu thuaj tre herë.

سُبْحَانَكَ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي، إِنَّهُ
لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ

Subhāneke innī ḏhalemte nefsī fagfirli innehū
lā jagfirudh-dhunūbe il-lā ent

“I dëlirë je Ti o All-llahu im, unë i kam bërë
zullum vetes sime. Më fal mua, ngase nuk ka
kush që m’i falë gjynahet pos Teje”.¹³

I Dërguari ﷺ ka thënë: Ajo që bëhet mbulesë ndërmjet syve të xhinnëve dhe pjesëve intime të bijve të Ademit, është që kur të hyjë ndonjëri prej jush në nevojtoare (banjo) të thotë:

بِسْمِ اللّٰهِ

Bismil-lāh.¹⁴

Pastaj thuaj:

اللّٰهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخُبُثِ وَالْخُبَائِثِ

All-llāhumme innī eūūdhu bike minel ħubuthi
vel ħabāith

“O All-llahu im, unë kërkoj mbrojtje te Ti nga të ndytit dhe ndytësirat”.¹⁵

E kur të dalësh nga nevojtorja (banjoja) thuaj:

غُفْرَانَكَ

Gufrānek “(Kërkoj) Faljen Tënde”.¹⁶

Kur të marrësh abdest thuaj:

بِسْمِ اللّٰهِ

Bismil-lāh.¹⁷

Gjatë abdestit thuaj:

اللّٰهُمَّ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي، وَوَسِّعْ

لِي فِي دَارِي، وَبَارِكْ لِي فِي رِزْقِي

All-llāhummagfirli dhenbī ve vessiī li fi dāri ve
bārik li fi rizkī

“O All-llahu im, ma fal gjynahun tim, ma bëj të gjerë shtëpinë dhe më sjell bekim në rrizkun tim”.¹⁸

I Dërguari ﷺ ka thënë: Çdonjëri nga ju i cili merr abdest dhe e merr me kujdes, duke e kapërcyer kufirin e gjymtyrëve me larje dhe në fund thotë:

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

Eshhedu en lā ilāhe il-lall-llāh, vaḥdehū lā
sherike leh, ve eshedu enne Muḥammeden
ābduhū ve resūluh

“Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut, Një i vetëm, nuk ka ortak dhe dësh-

‘Tij’, atij do t’i hapen tetë dyert e xhennetit dhe ai do të mund të hyjë në të nga cilado prej tyre.¹⁹

Pastaj thuaj:

اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ التَّوَابِينَ وَاجْعَلْنِي مِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ

All-llāhummexh’ālnī minet-tevvābīne vexh’ālnī
minel mutetahhīrīn

“O All-llahu im, më bën nga të penduarit dhe më bën nga të pastërtit”.²⁰

Kur të nisesh për në xhami

Duhet ta thuash atë që e thua kur të dalësh nga shtëpia duke ia bashkangjitur edhe këtë:

اللَّهُمَّ اجْعَلْ فِي قَلْبِي نُورًا وَفِي لِسَانِي نُورًا وَاجْعَلْ فِي سَمْعِي نُورًا وَاجْعَلْ فِي بَصَرِي نُورًا، وَاجْعَلْ مِنْ خَلْفِي نُورًا وَمِنْ أَمَامِي نُورًا، وَاجْعَلْ مِنْ فَوْقِي نُورًا وَمِنْ تَحْتِي نُورًا اللَّهُمَّ اعْظِنِي نُورًا

All-llāhummexh’āl fī kalbī nūren ve fī lisānī nūren vexh’āl fī semīī nūren vexh’āl fī bešarī nūren vexh’āl min ħalfī nūren ve min emāmī

All-llāhummātinī nūrā

“O All-llahu im, bëj që në zemrën time të kem nur, në gjuhën time të kem nur, në dëgjimin tim të kem nur, në shikimin tim të kem nur, mbrapa e para të kem nur, lart e poshtë të kem nur. O All-llahu im, ma jep nurin (dritën)”²¹

Vlera e shkuarjes në xhami

I Dërguari ﷺ ka thënë: “Kush pastrohet në shtëpi të tij (me abdest ose me gusël), e pastaj shkon në njërën nga shtëpitë e All-llahut për të kryer një farz prej farzeve të All-llahut, hapat e tij bëhen të tillë që njëri ia shlyen një gjynah kurse tjetri ia ngrit një shkallë (të mirësisë)”²²

Kur të hysh apo të dalësh nga xhamia

I Dërguari ﷺ ka thënë: Kur dikush nga ju hyn në xhami, le ta përshëndesë me selam Pejgamberin ﷺ dhe le të thotë:

اللَّهُمَّ افْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ

All-llāhummeftaḥ lī ebvābe raḥmetik

tit Tënd”. E kur të dalë le të thotë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ

All-llāhūmmē innī es'eluke min fadlik

“O All-llahu im, unë kërkoj të mirat Tua”.²³

Falësi në xhami duhet të hyjë me këmbën e djathtë, e të dalë me këmbën e majtë, duke u mbështetur në thënien e Aishes radijall-llahu anha: “I Dërguari ﷺ preferonte të fillojë me të djathtë në çdo gjë: në pastrim, krehje dhe veshmbathje”.²⁴

Shtesë e vlefshme

Është mustehab (e preferuar) të fillohet me të djathtën në çdo gjë që është punë e ndershme siç janë: abdesti, gusli, tejemmumi, veshja e rrobave të ndryshme, hyrja në xhami, përdorimi i misvakut, syrmeve, prerja e thonjve, shkurtimi i mustaqeve, pastrimi nën sqetulla, rruarja e kokës, dhënia e selamit në namaz, ushqimi, pija, përshëndetja, prekja e Gurit të Zi (në Qabe), dalja nga nevojtorja, marrja dhe dhënia dhe në rastet tjera që kanë të njëjtin kuptim.

rastet e kundërta me ato që u çekën më lartë, siç është të pështyerit nga e majta, hyrja në nevojto-re, dalja nga xhamia, zhveshja e rrobave, zbat-hja e këpucëve, çorapeve, pastrimi pas nevojës dhe bërja e gjërave që janë të papastra etj.

(Imam Neveviu në Rijadus Salihin).

Kur ta dëgjosh ezanin

I Dërguari ﷺ ka thënë: “Kur ta dëgjoni thirrjen (ezanin), thuani ashtu siç thotë muez-zini”.²⁵ Pos në rastet kur thuhet

حى على الصلاة

Hajje âleš-šalāh dhe

حى على الفلاح

Ĥajje âlel felāĥ, ngase në atë rast thuhet:

لا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

Lā ĥavle ve lā kuvvete il-lā bil-lāh

“Nuk ka ndryshim e as fuqi, pos me All-llahun”.

وَأَنَا أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ
 وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ، رَضِيتُ
 بِاللَّهِ رَبًّا وَبِمُحَمَّدٍ ﷺ رَسُولًا وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا

Ve ene eshhedu en lā ilāhe il-lall-llāhu
 vañdehū lā sherīke lehū ve enne
 Muḥammeden ābduhū ve resūluh. Radijtu bil-
 lāhi rabben ve bi Muḥammedin resūlen ve bil
 Islāmi dīnen

“Edhe unë dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër
 pos All-llahut, Një i vetëm e i pashoq dhe se
 Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Jam
 i kënaqur që All-llahun e kam Zot, Muham-
 medin ﷺ pejgamber dhe Islamin fe”, atij i falen
 gjynahet.²⁶

Pastaj e përshëndet me salavat Pejgamberin
 ﷺ.²⁷

Dhe ai që kur e dëgjon ezanin thotë:

اللَّهُمَّ رَبُّ هَذِهِ الدَّعْوَةِ التَّامَّةِ وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ آتِ مُحَمَّدًا
 الْوَسِيلَةَ وَالْفَضِيلَةَ وَابْعَثْهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتَهُ

All-llāhumme rabbe hādhihid-dāvetit-tāmmeti
 veşşalātil kāimeti āti Muḥammedenil vesīlete
 vel faḍīlete veb’āthhu mekāmen maḥmūdenil-
 ledhī veādteh

dhe namazit që po fillon, jepi Muhammedit ndërmjetësim dhe nderim. Ringjalle atë në një vend të lavdëruar të cilin ia ke premtuar”, fiton shefatin e Pejgamberit ﷺ në Ditën e Ringjalljes.²⁸

Dhe: “Lutja nuk refuzohet kur bëhet mes ezanit dhe ikametit, prandaj bën dua”.²⁹

Po ashtu I Dërguari ﷺ ka thënë: “Thuaj siç thonë (muezinët), e kur të përfundosh bën dua se të jepet (ajo që lutesh). “Po, nëse i lutesh All-llahut do ta sjellë”.³⁰

Kur ta marrësh tekbinin fillestar për namaz

Thuaj para leximit:

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ وَتَبَارَكَ اسْمُكَ وَتَعَالَى
جَدُّكَ وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ

Subhānekall-llāhumme ve bi hāmdike ve
tebārekesmuke ve teāālā xhedduke ve lā ilāhe
gajruk

“I dëlirë je o All-llahu im si dhe i falënderuar, i bekuar është emri Yt, e lartësuar është madhëria Yte dhe nuk ka hyjni tjetër pos Teje”.³¹

اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ
وَالْمَغْرِبِ، اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنْ خَطَايَايَ كَمَا يُنْقَى الثُّوبُ الْأَبْيَضُ
مِنَ الدَّنَسِ، اللَّهُمَّ اغْسِلْنِي مِنَ خَطَايَايَ بِالثَّلْجِ وَالْمَاءِ وَالْبَرَدِ

All-llāhumme bā'id bejnī ve bejne ḥatājāje
kema bāādte bejnel mashriki vel magrib.

All-llāhumme nekkinī min ḥatājāje kema
junekḱith-thevbul ebjeđu mined-denes.

All-llāhum magsilnī min ḥatājāje bith-thelxhi vel-
māi vel-bered

“O All-llahu im, më largo nga gabimet siç e ke larguar Lindjen nga Perëndimi. O All-llahu im, më pastro nga gabimet siç pastrohet tesha e bardhë nga ndytësira. O All-llahu im, më laj nga gabimet me borë, ujë e akull”.³²

Kur shkon në ruku

Thuaj:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ

Subḥāne rabbijel āḏḥīm

“I dëlirë është Zoti im i madh”.³³

سُبُّوحٌ قُدُّوسٌ رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ

Subbūhūn kuddūsun rabbul melāiketi ver-rūh

“I dëlirë, i shenjtëruar është Zoti i melekëve dhe Shpirtit (Xhibrilit)”.³⁴

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي

Subhānekall-llāhumme rabbenā ve bi hāmdik.

All-llāhummagfirli

“I dëlirë je o All-llahu im, që je Zoti ynë, si dhe i falënderuar. O All-llahu im, më fal”.³⁵

سُبْحَانَ ذِي الْجَبْرُوتِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْعِزَّةِ وَالْكَرَمِ

Subhāne dhilxheberūti velmelekūti velkibrijāi

velādīhameh

“I dëlirë është Ai që ka fuqinë, pronësinë, lartësinë dhe madhërinë”.³⁶

Gjatë sexhdes

Thuaj:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى

Subhāne rabbijel aālā

“I dëlirë është Zoti im i lartë”.

كُلُّهُ، وَدِدِّهِ وَجَلِّهِ، وَأَوَّلُهُ وَأَخِرُهُ، وَعِلَانِيَّتِهِ وَسِرِّهِ

All-llāhummagfirilī dhenbī kul-lehū ve dikkahū
ve xhil-lehū ve evvelehū ve āhirehū ve
ālānijetehū ve sir-reh

“O All-llahu im, ma fal gjynahun tim në përgjithësi, të voglin dhe të madhin, të parin dhe të fundit, të dukshmin dhe të fshehtin”.³⁷

Kur të ngrihesh nga rukuja

Thuaj:

سَمِعَ اللهُ لِمَنْ حَمِدَهُ

Semiâll-llāhu limen hāmidēh

“All-llahu e dëgjoji atë që e falënderoi”.³⁸

Pastaj thuaj:

رَبُّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ

Rabbenā ve lekel hāmdu hāmden kethiren
tajjiben mubāreken fih

“Zoti ynë, për Ty është falënderimi, falënderimi i shumtë, i mirë e i bekuar”.³⁹

ما بَيْنَهُمَا وَمَلءَ مَا شِئْتَ مِنْ شَيْءٍ بَعْدَ أَهْلِ الثَّنَاءِ وَالْمَجْدِ ،
 أَحَقُّ مَا قَالَ الْعَبْدُ وَكُنَّا لَكَ عَبْدٌ ، اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا
 أَعْطَيْتَ وَلَا مُعْطِيَ لِمَا مَنَعْتَ وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ

Rabbenā velekel hāmdu mil'es-semāvāti ve
 mil'el erđi ve mil'e mā bejnehumā ve mil'e mā
 shi'te min shej'in bādu ehleth-thenāi vel-
 mexhd. Eñakku mā kālel ābdu ve kul-lunā leke
 ābd. All-llāhumme lā māniā limā aātajte ve lā
 muā'tije limā menā'te ve lā jenfeū dhel xheddi
 minkel xhedd

“Zoti ynë, Ty të takon falënderimi sa pranon
 qielli, sa pranon toka, sa pranon gjithëçka që
 është midis tyre dhe sa pranon ajo që është në
 vullnetin Tënd pas tyre. Të gjithë të lartësojnë e
 madhërojnë. Më meritörja që e tha rob, kurse të
 gjithë ne jemi robërit e Tu: O All-llahu im, nuk
 ka kush që mund të pengojë kur Ti jep, nuk ka
 kush që mund të japë kur Ti pengon dhe nuk ka
 mundësi i pasuri me pasurinë e tij të
 pavarësohet nga Ti”.

Duaja ka për qëllim atë se pasuria dhe fati
 nuk mund t'i sjellin dobi të pasurit për t'u pava-
 rësuar nga All-llahu, as që mund ta mbrojnë nga
 dënimi e as që mund t'ia shtojnë sevapet.⁴⁰

Thuaj:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي وَارْحَمْنِي وَاهْدِنِي وَاجْبُرْنِي
وَ عَافِنِي وَارْزُقْنِي

All-llāhummagfirli verhāmni vehdinī vexhburnī
ve āāfinī verzuqni

“O All-llahu im më fal, më mëshiro, më udhëzo, më drejto, më jep shëndet dhe më furnizo”.⁴¹

Ose thuaj:

رَبِّ اغْفِرْ لِي، رَبِّ اغْفِرْ لِي

Rabbigfirli rabbigfirli

“Zot më fal, Zot më fal”.⁴²

Muhammedi alejhisselam ka thënë: “Robi është më afër Zotit të tij atëherë kur është në sexhde, andaj lutuni sa më shumë në të”.⁴³

Pasi ta përfundosh teshehhudin

Para se të japësh selam thuaj:

القبر. وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ
 فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ، اَللّٰهُمَّ اِنِّيْ اَعُوذُ بِكَ مِنَ الْمَأْتَمِّ وَالْمَغْرَمِ
 "اَللّٰهُمَّ اِنِّيْ ظَلَمْتُ نَفْسِيْ ظُلْمًا كَثِيْرًا، وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوْبَ اِلَّا
 اَنْتَ، فَاغْفِرْ لِيْ مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَاَرْحَمِنِيْ، اِنَّكَ اَنْتَ الْغَفُوْرُ
 الرَّحِيْمُ

All-llāhumme innī eūūdhu bike min ādhābil
 kabri ve eūūdhu bike min fitnetil mesiḥid-dexh-
 xhāli ve eūūdhu bike min fitnetil maḥjā vel
 memāt. All-llāhumme innī eūūdhu bike minel
 me'themi vel magrem. All-llāhumme innī
 d̄halemtu nefsi d̄hulmen kethiren ve lā
 jagfirudh-dhunūbe il-lā ent. Fagfirlī magfireten
 min īndike verḥamnī inneke entel gafūrur-
 raḥīm

“O All-llahu im, kërkoj mbrojtje te Ti nga
 vuajtja e varrit, nga fitneja e dexhxhallit, nga
 sprovat e jetës dhe të vdekjes. O All-llahu im,
 kërkoj mbrojtje te Ti nga zhytja në gjynahe dhe
 borxhe. O All-llahu im, unë i kam bërë shumë
 zullum vetvetes. Nuk ka kush që m’i falë gjyna-
 het pos Teje, më fal mua me faljen Tënde dhe
 më mëshiro. Vërtet, Ti je falës dhe i mëshir-
 shëm”.⁴⁴

استغفر الله

Estagfirull-llāh (I kërkoj falje All-llahut) - tre herë, e pastaj:

اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ، وَمِنْكَ
السَّلَامُ، تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

All-llāhumme entesselāmu ve minkesselāmu
tebārekte jādhel xhelāli vel ikrām

“O All-llahu im, Ti je paqe, nga Ti buron
paqja. I bekuar je o Ti që ke madhëri e bujari”.⁴⁵

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ،
وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ، وَلَا
مُعْطَى لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ

Lā ilāhe il-lāll-llāhu vaḥdehū lā sherike leh,
lehu mulku ve lehu ḥamdu ve huve ālā kul-li
shej'in kādir. All-llāhumme lā māniā limā
aātajte ve lā muā'tije limā menā'te ve lā jenfeū
dhel xheddi minkel xhedd

“Nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut, i vetëm
është dhe i pashoq. Atij i takojnë sundimi dhe
falënderimi dhe Ai për çdo gjë është i mund-
shëm. O All-llahu im, nuk ka kush që mund të
pengojë kur Ti jep, nuk ka kush që mund të japë
kur Ti pengon dhe nuk ka mundësi i pasuri me
pasurinë e tij të pavarësohet nga Ti”.⁴⁶

اللَّهُمَّ اعْنِي دَارَكَ وَسُكْرَكَ وَحَسَنَ عِبَادَتِكَ
All-Ilāhumme eīnnī ālā dhikrike ve shukrike ve
husni ibādetik

“O All-llahu im, më ndihmo të të përkujtoj,
të të falënderoj dhe përkryeshëm të të adhu-
roj”.⁴⁷

“Kush e lexon Ajetul Kursinë pas çdo na-
mazi farz, nuk do ta ndalojë hyrjen e tij në
xhennet asgjë, pos nëse vdes (para se ta
lexojë)”.⁴⁸

Po ashtu duhet ta lexojë edhe Kulhu-
vall-llahun dhe dy Kul-eudhat.⁴⁹

Kush thotë:

سُبْحَانَ اللَّهِ

Subhānall-Ilāh (I dëlirë është All-llahu) tridhjetë
e tri herë,

الْحَمْدُ لِلَّهِ

El-hāmdulil-lāh (Falënderim All-llahut) tridhjetë
e tri herë dhe

اللَّهُ أَكْبَرُ

All-Ilāhu ekber (All-llahu është më i madhi)
tridhjetë e tri herë e pastaj thotë të njëqindën
herë:

عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ،

Lā ilāhe il-lall-llāhu vaḥdehū lā sherike leh,
lehul-mulku ve lehul-ḥamdu ve huve ālā kul-li
shej'in kādīr

“Nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut, i vetëm është dhe i pashoq. Atij i takon sundimi dhe falënderimi dhe Ai për çdo gjë është i mundshëm”, i falen gjynahet edhe nëse janë sa shku-
ma e detit.⁵⁰

Pas namazit të sabahut dhe akshamit thuaj
dhjetë herë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ
يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

Lā ilāhe il-lall-llāhu vaḥdehū lā sherike leh,
lehul mulku ve lehul ḥamdu juḥjī ve jumītu ve
huve ālā kul-li shej'in kādīr

“Nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut, që është i vetëm dhe i pashoq. Atij i takojnë sundimi dhe falënderimi, (Ai) ngjallë dhe vdes (çdo gjë) dhe Ai për çdo gjë është i mundshëm”.⁵¹

Dhe thuaj shtatë herë:

All-llāhumme exhirnī minen-nār

“O All-llahu im, më ruaj nga zjarri”.⁵²

Dije se koha më e vlefshme për lutje gjatë ditës është lutja pas namazit të sabahut.

I Dërguari ﷺ tha: “Kush e falë sabahun, e pastaj ulet në xhami derisa të falë dy rekate duhanë (namazin e paradrekës), atij i shkruhet sa shpërblimi i një haxhxi dhe umreje të pranueshme”.⁵³

Lutjet e mëngjesit dhe të mbrëmjes

All-llahu i lartësuar thotë: “Lutu duke e falënderuar Zotin tënd para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij”.

Lutjet e mëngjesit thuhën mes agimit dhe lindjes së diellit, kurse ato të mbrëmjes mes ikindisë dhe akshamit. Në mbrëmje themi **Emsejnā** (arritëm mbrëmjen) në vend të **Ašbaħnā** (arritëm mëngjesin), pastaj fjalët tjera radhiten sipas kohës.

Thuhën “Kulhuvall-llahu” dhe dy “Kul-eudhat” tri herë. “Ato mjaftojnë për çdo gjë”.⁵⁴

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ

Subhānall-llāhi ve bi hāmdih

“I dëlirë është All-llahu si dhe i falënderuar”
njëqind herë, Ditën e kijametit askush nuk vjen
me ndonjë lutje më të bukur pos atij që vjen me
të njëjtën ose shton diç më tepër.⁵⁵

Prej lutjeve të mëngjesit dhe të mbrëmjes
janë këto:

أَصْبَحْنَا وَأَصْبَحَ الْمَلِكُ لِلَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ
وَحَدُّهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ
قَدِيرٌ، رَبِّ أَسْأَلُكَ خَيْرَ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَخَيْرَ مَا بَعْدَهُ،
وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَشَرِّ مَا بَعْدَهُ، رَبِّ أَعُوذُ
بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَسُوءِ الْكِبَرِ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ فِي
النَّارِ، وَعَذَابِ فِي الْقَبْرِ

Ašbañā ve ašbañal-mulku lil-lāhi vel-
hāmdulil-lāh. Lā ilāhe il-lall-llāhu vañdehu lā
sherike leh, lehul mulku ve lehul hāmdu ve
huve ālā kul-li shej'in kādir. Rabbi es'eluke
ħajre mā fī hādhel jevmi ve ħajre mā bādehū
ve eūūdhu bike min sher-ri mā fī hādhel jevmi
ve sher-ri mā bādeh. Rabbi eūūdhu bike minel
keseli ve sūil kiber. Rabbi eūūdhu bike min
ādhābin fin-nāri ve ādhābin fil kabr

All-llahun. All-llahut i qoftë falënderimi. Nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut, Një i vetëm dhe i pashoq. Atij i takojnë sundimi dhe falënderimi dhe Ai për çdo gjë është i mundshëm. O Zoti im, të lus për të mirat e kësaj dite dhe të mirat që vinë pas saj, kërkoj mbrojtje nga të këqijat e kësaj dite dhe të këqijat që vinë pas saj. Zoti im, të lus të më ruash nga përtacia dhe e keqja e mendjemadhësisë. Zoti im, më ruaj nga dënimi në zjarr dhe dënimi në varr”.⁵⁶

اللَّهُمَّ بِكَ أَصْبَحْنَا (أَمْسَيْنَا) وَبِكَ أَمْسَيْنَا
 (أَصْبَحْنَا) وَبِكَ نَحْيَا وَبِكَ نَمُوتُ وَإِلَيْكَ النُّشُورُ (المصيرُ)
 All-llāhumme bike ašbaḥnā (emsejnā) ve bike
 emsejnā (ašbaḥnā) ve bike naḥjā ve bike
 nemūtu ve ilejken-nushūr (ilejkel mešir)

“O All-llahu im, me Ty gdhimë (ngrysëm) dhe me Ty ngrysëm (gdhimë), me Ty ngjallemi dhe me Ty (me vullnetin Tënd) vdesim dhe te Ti është kthimi (takimi i fundit)”.⁵⁷

نَبِيْنَا مُحَمَّدٌ ﷺ وَعَلَىٰ مِلَّةِ أَبِيْنَا إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا مُّسْلِمًا وَمَا
كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ

Ašbaḥnā âlā fitretil Islāmi ve kelimetil ihlāsi ve
âlā dīni nebijjinā Muḥammedin ve âlā mil-leti
ebīna Ibrahīme ḥanīfen muslimen ve mā kāne
minel mushrikīn

“U zgjuam në natyrshmërinë e Islamit, fjalën
e sinqertë, dinin e Pejgamberit tonë, Muham-
medit ﷺ, miletin e babait tonë Ibrahimit, të
pastër e musliman, që nuk ishte prej idhujta-
rëve”.⁵⁸

Kush thotë kur ta arrijë mëngjesin apo
mbrëmjen:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَصْبَحْتُ
أَشْهَدُكَ وَأَشْهَدُ حَمَلَةَ عَرْشِكَ، وَمَلَائِكَتَكَ وَجَمِيعَ خَلْقِكَ، أَنْكَ
أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَحْدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ، وَأَنْ مُحَمَّدًا
عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ

All-llāhumme innī ašbaḥtu ushhideke ve
ushhidu ḥamelete ârshike ve melāiketeteke ve
xhemīâ ḥalkike enneke entell-llāhu lā ilāhe il-lā
ente vaḥdeke lā sherīke leke ve enne
muḥammeden âbduke ve resūluk

dhe dëshmoj për bartësit e arshit Tënd, për melaqet Tua, të gjitha krijesat Tua, se Ti je All-llahu që s’ka hyjni veç Teje, Një i vetëm je dhe i pashoq dhe se Muhammedi është rob i Yt dhe peygamberi Yt” katër herë, All-llahu do ta lirojë nga zjarri.⁵⁹

اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ،
وَأَنَا عَلَىٰ عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا
صَعَّتُ، أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ، وَأَبُوءُ بِذَنْبِي، فَاغْفِرْ لِي،
فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ

All-llāhumme ente rabbī, lā ilāhe il-lā ente,
hālaktenī, ve ene ābduke, ve ene ālā āhdike
ve vādike mestetā’t. Eūūdhu bike min sher-ri
mā šanā’t. Ebū’u leke bi nīmetike āleje ve
ebūu bi dhenbī, fagfirī, fe innehū lā jagfirudh-
dhunūbe il-lā ent

“O All-llahu im, Ti je Zoti im, nuk ka hyjni tjetër pos Teje, më ke krijuar e unë jam rob i Yt. Unë i përmbahem besëlidhjes dhe premtimit Tënd aq sa mundem. Kërkoj mbrojtje te Ti nga e keqja e asaj që e kam vepruar. Pranoj para Teje për dhuntinë Tënde ndaj meje dhe pranoj

falë gjynahet veç Teje”

Kush e thotë këtë kur vjen mbrëmja dhe vdes atë natë, hyn në xhennet, dhe kush e thotë kur vjen mëngjesi dhe vdes atë ditë, hyn në xhennet.⁶⁰

اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي بَدَنِي ، اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي سَمْعِي
اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي بَصَرِي ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكُفْرِ
وَالْفَقْرِ ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ

All-llāhumme āāfinī fī bedenī. All-llāhumme
āāfinī fī semīī. All-llāhumme āāfinī fī bešarī.
All-llāhumme innī eūūdhu bike minel kufri vel-
fakri. All-llāhumme innī eūūdhu bike min
ādhābil kabr. Lā ilāhe il-lā ent

“O All-llahu im, më jep shëndet në trup. O All-llahu im, më jep shëndet në dëgjim. O All-llahu im, më jep shëndet në shikim. O All-llahu im, kërkoj mbrojtje te Ti nga kufri dhe varfëria. O All-llahu im, kërkoj mbrojtje te Ti nga vuajtja e varrit. Nuk ka hyjni tjetër, veç Teje” - këtë duhet thënë tri herë.⁶¹

والأرض، رَبُّ كُلِّ شَيْءٍ وَمَلِيكُهُ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ،
 أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ نَفْسِي وَشَرِّ الشَّيْطَانِ وَشَرِّكُمْ، وَأَنْ أُقْتَرِفَ
 عَلَى نَفْسِي سُوءًا أَوْ أُجْرَهُ إِلَى مُسْلِمٍ

All-llāhumme āālimel gajbi vesh-shehādeti
 fātires semāvāti vel-erđi rabbe kul-li shej'in ve
 melīkehu eshhedu en lā ilāhe il-lā ent. Eūūdhū
 bike min sher-ri nefsi ve sher-rish shejtāni ve
 shirkihī ve en akterife ālā nefsi sūen ev exhur-
 rehū ilā muslim

“O All-llahu im, Ti që di të fshehtën dhe të
 dëshmuarën, Krijues i qiejve dhe i tokës, Zot i
 gjithçkaje dhe zotërues i saj. Dëshmoj se nuk ka
 hyjni tjetër pos Teje. Kërkoj mbrojtje te Ti nga
 sherri i epshit tim dhe sherri i shejtanit dhe i
 shirkut të tij. Dhe, (nga ajo) që t'i kundërvihem
 vetes me të keq ose t'ia bëj atë ndonjë musli-
 mani”.⁶²

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ،
 اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي دِينِي وَدُنْيَايَ وَأَهْلِي
 وَمَالِي، اللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَتِي وَأَمِّنْ رَوْعَتِي، اللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ
 بَيْنِ يَدَيَّ وَمِنْ خَلْفِي، وَعَنْ يَمِينِي وَعَنْ شِمَالِي وَمِنْ فَوْقِي،
 وَأَعُوذُ بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي

āhireh. All-llāhumme innī es'elukel āfve vel

āāfijete fī dīnī ve dunjāje ve ehli ve māli.

All-llāhummetur āvretī ve emmin rev'āti.

All-llāhummaḥ-fidḥnī min bejni jedejje ve min ḥalfī ve ān jemīnī ve ān shimālī ve min fevkī ve eūūdhu bi adḥametike en ugtāle min taḥtī

“O All-llahu im, kërkoj shpëtimin në dunja dhe ahiret. O All-llahu im, të lus për falje dhe shpëtim në fenë, dunjanë, familjen dhe pasurinë time. O All-llahu im, ma ruaj avretin tim, ma siguro drojën time. O All-llahu im, më mbroj para, mbrapa, nga e djathta, nga e majta e nga lart, kurse nga poshtë me madhërinë Tënde kërkoj të më mbrosh që të mos rrëshqas”.⁶³

Secili rob i cili thotë në çdo mëngjes e mbrëmje:

بِسْمِ اللّٰهِ الَّذِي لَا يَضُرُّ مَعَ اسْمِهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

Bismil-lāhil-ledhī lā jedur-ru meā ismiḥi shej'un fil-erḍi ve lā fis-semāi ve huves-semīūl ālim

“Me emër të All-llahut që pa emrin e Tij nuk mund të dëmtohet askush në tokë e në qiell dhe Ai dëgjon dhe di gjithçka” - nuk do ta dëmtojë asgjë.⁶⁴

mbrëmjen:

رَضِيتُ بِاللَّهِ رَبًّا وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا وَبِمُحَمَّدٍ ﷺ نَبِيًّا

Radijtu bil-lāhi rabben ve bil islāmi dīnen ve bi
Muḥammedin nebijjā

“Jam i kënaqur që All-llahun e kam Zot, Islamin fe dhe Muhammedin ﷺ pejgamber”, All-llahu ia ka bërë detyrë Vetes që ta kënaq atë”.⁶⁵

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ

Eûūdhu bi kelimātil-lāhit-tāmmāti min sher-ri
mā ḥalek

“Kërkoj mbrojtje përmes fjalëve të plota të All-llahut nga e keqja që e krijoi” - thuaje tre herë.

I Dërguari ﷺ ka thënë: Kush për çdo ditë kur zgjohet dhe kur bie të flejë thotë:

حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

Ḥasbijall-llāhu, lā ilāhe il-lā huve ālejhi
tevekkeltu ve huve rabbul arshil aḏḥīm

“Më mjafton All-llahu, nuk ka hyjni tjetër përveç Tij, Atij i mbështetem dhe Ai është Zoti i Arshit të madh” shtatë herë, All-llahu do t'i

çështjeve të dunjasë dhe ahiretit.⁶⁶

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا وَرِزْقًا طَيِّبًا وَعَمَلًا مُتَقَبَّلًا

All-llāhumme innī es'eluke ilmen nāfiān ve
rizkan tajjiben ve āmelen mutekabbelā

“O All-llahu im, unë kërkoj prej Teje dituri
të dobishme, furnizim të mirë dhe punë të pra-
nuar”.⁶⁷

يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ، بِرَحْمَتِكَ أَسْتَغِيْثُ، أَصْلِحْ لِيْ
شَأْنِيْ كُلَّهُ، وَلَا تَكِلْنِيْ إِلَى نَفْسِيْ طَرْفَةَ عَيْنٍ

Ja ħajju jā kajjūmu bi raĥmetike estegīthu
ašliĥli she'ni kul-lehū ve lā tekilni ilā nefsi
tarfete ājn

“O i Gjallë, o Vigjilues, duke u mbështet në
mëshirën Tënde kërkoj ndihmë. Ma përmirëso
gjendjen time në tërësi e mos më lë t'i mbështe-
tem vetes as sa një mbyllje syri”.⁶⁸

nuk përcaktohen me kohë

Dy fjalë janë të lehta për gjuhë, të rënda në peshore dhe të dashura te i Gjithëmëshirshmi:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ، سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ

Subhānall-llāhi ve bi ḥamdihī, subhānall-llāhil
âḏhīm

“I dëlirë dhe i falënderuar është All-llahu, i dëlirë është All-llahu i madh”.⁶⁹

Fjalët më të dashura te All-llahu janë këto katër:

سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ . وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ

